



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 122/13
Prishtinë, më 24.07.2013, ora 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki–Iseini, Dashurije Canolli dhe Arbëreshë Kosumi.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjeve të identifikuar në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e vizave;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjeve të identifikuar në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e vizave

Me dhjetë vota për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama) një Abstenim (Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër, Komisioni nxorri këtë :

Rekomandim

Projektligjet e identifikuar në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e vizave, nuk përbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjin nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja konstaton se ky projektligj dhe amendamentet nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

Kryetarja njofton se Komisioni për Siguri gjatë mbledhjes së sotme do të përfundojnë projektligjet, nëse i përfundojnë dhe arrijnë me kohë kemi mundësi që nesër gjatë kohës së pauzës të mblidhemi dhe ti analizojmë.

Latif Gashi duke pas parasysh rëndësinë e këtyre ligjeve është mirë të dihet se në çfarë ore e mban mbledhjen Komisioni për Siguri. Do të ishte mirë që sot të mbahet mbledhja Komisionit në mënyrë që nesër të iu ipet mundësia shëfave të grupeve parlamentare që ti fusin në rend të ditës duke pas parasysh që vetëm kjo seancë është gjatë këtij muaji.

Kryetarja njofton se nesër në ora 9 do të mbahet mbledhja, ku në rend dite do të jenë projektligjet që lidhen me liberalizimin e vizave.

Mbledhja përfundoi: 11:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona